



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1887 prot.

Tiranë, më 17.04.2020

U R D H Ë R

Nr. 263, datë 17.04.20

PËR

**PËRCAKTIMIN E ORAREVE TË LËVIZJES PËR KËMBËSORËT
PENSIONISTË, TË SËMURËVE KRONIKË NË TRAJTIM MJEKËSOR
DHE TË RREGULLAVE PËR LËVIZJEN ME MJETE PRIVATE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

U R D H Ë R O J:

1. Lejohet lëvizja e këmbësorëve pensionistë ditën e shtunë datë 18.4.2020 deri në orën 11.00, të shoqëruar me jo më shumë se një person në krah.
2. Duke filluar nga dita e hënë, datë 20.4.2020, qytetarët/të sëmurët kronikë, që lëvizin për trajtime mjekësore, të vërtetuar me kopje të dokumentacionit të strukturës shëndetësore dhe që marrin shërbim shëndetësor në spitale (sipas rregullave të përcaktuara për periudhën e epidemisë), apo shoqëruesit e tyre, duhet të vetëdeklarojnë në portalin *e-Albania* duke përcaktuar orarin e lëvizjes, itinerarin me destinacionin përkatës si dhe të dhënat e mjetit, në rastet kur lëvizja kryhet me atë.
3. Duke filluar nga dita e hënë, datë 20.4.2020, lejohet lëvizja me mjete private, sipas autorizimit përkatës, e të gjithë personave të cilët janë në marrëdhënie pune në një nga veprimtaritë e lejuara, në fashat oraret të përcaktuara ose sipas orarit të diktuar nga natyra e punës e të paralajmëruara, vetëm për itinerarin shtëpi – punë dhe anasjelltas, pa ndalesa të ndërmjetme.

4. Personat e lejuar të lëvizin me mjete private, sipas pikës 3, të këtij urdhri, lejohen që të marrin vetëm një pasagjer familjar me autorizim pune ose një koleg nga i njëjti vend pune, i cili duhet të ulet në pjesën e pasme të automjetit, i pozicionuar diagonal me drejtuesin e mjetit.
5. Çdo rregull i përcaktuar nga urdhrat e mëparshëm, që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

